

VENDIM
Nr. 19, datë 14.7.2014

PËR RINOVIM LICENCE “ELBER” SHPK

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik operatorit “Elber” sh.p.k., me:
Drejtues ligjor: Altin Cenolli;
Drejtues teknik: Julian Doci.
2. Operatori “Elber” sh.p.k. autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A:Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C:Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Elbasan.
4. Kjo licencë është e vlefshme deri më datë 19.1.2015 siç është përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 6, datë 19.1.2011.

KRYETARI
Avni Dervishi

KËRKESË

Shtetasi Gazment Mëhalla, i biri i Dervishit dhe i Sabiresë, i datëlindjes 19.5.19992, lindur dhe banues në Mollas, Elbasan, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Agron Mëhalla.

KËRKUESI
Gazment Mëhalla